


Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	03.08.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Abdurrahman URUQI Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit në komunën e Ferizajt
CC:	z. Muharrem SVARQA Kryetar i Komunës së Ferizajt
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin " Furnizimi i fermerëve me makina mjelëse "

I nderuari z. Uruqi,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin " **Furnizimi i fermerëve me makina mjelëse** " me numër prokurimi: 656 15 275 121:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " **Furnizimi i fermerëve me makina mjelëse** " me numër prokurimi: 656 15 275 121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

Arsyetim

Komuna e Ferizajt si Autoritet Kontraktues, përmes Zyrës për Prokurim ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull " **Furnizimi i fermerëve me makina mjelëse** " me numër prokurimi: 656 15 275 121, të cilat janë publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.15.07.2015. Agjencia kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë procedurë të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë trajtimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, Agjencia kundër Korrupsionit ka hasur në të dhëna të cilat janë në kundërshtim me Legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

Në njoftimin për kontratë i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, me datë 15.07.2015 tek rubrika III.2.4) Kapaciteti teknike dhe profesionale pika 1. **Ka kërkuar:1 Makinat duhet të jenë humane, 2.Rezervuari të ketë kapacitet 40 litra, 3.Pesha të jetë 50kg, 4.Motorri monofaz 0550KW**, kërkesë kjo e cila konsiderojmë se bien ndesh me Legjislacionin në fuqi për Prokurimin Publik.

Autoriteti kontraktues me konkretisht njësia kërkuese duhet të ketë kujdes dhe të përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të mos jenë vlera fikse por të caktohet minimum i kërkesave teknike që të jenë të hapura për të gjithë operatorët ekonomik të cilët mund të bëjnë furnizime me makina të tilla.

Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

AKK gjatë shfletimit të dokumentacionit për këtë aktivitet të prokurimit ka konstatuar se në Dosjen e Tenderit tek Seksioni II. Fleta e të dhënave të tenderit në rubrikën 13.2-Siguria e Tenderit, autoriteti kontraktues ka kërkuar sigurinë e tenderit në vlerë prej 1,000.00€ nga vlera e ofertës me validitet **90 ditë**, si dhe tek rubrika 21.1 Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë **90 ditë**.

Bazuar në legjislacionet në fuqi për Prokurim Publik, siguria e tenderit duhet të kërkohej për një periudhë prej tridhjetë(30) ditë pas skadimit të periudhës së validitetit të tenderit. Në këtë rast Autoriteti Kontraktues dot duhej që validitetin e sigurisë së tenderit ta kërkonte në periudhë prej **120 ditëve**.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin **69** Aftësitë në teknike dhe/ose profesionale të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042,dhe nenin **26** Siguria e Tenderit të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj AKK rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të shmang praktikën e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

AGOSVO *